

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, sipas gjyqtarit Halil Zahiri, me Ass. Ligjor Baki Sylejmani e Vlora Selmani-Rahimi në çështjen juridiko-civile të paditësit, A. M, nga f. P, kundër të paditurit, K. Sh, nga f. P, K.e Gj, për vërtetimin dhe njohjen të drejtës së pronësisë, jasht seancës kryesore, më dt. 20.09.2016 këtë

A K T G J Y K I M
Në bazë të pranimit-pohimit

I. APROVOHET si e bazuar kërkespacia e A. M, kundër të paditurit K. Sh dhe **VËRTERTOHET** se paditësi në bazë të pohimit-pranimit, nga i padituri, sipas kontratës verbale për shitblerjen e pasurisë së paluajtëshme dhe mbajtjes, e ka fituar të drejtën e pronësisë për ngas.kad.nr....., me kulturë arë e kl. III, në sipërfaqe prejha, e cila gjende në v. q. rr. " " e regjistruar në emër të ndj. Zyhrije Shemsiu, /gjyshja e paditësit/, sipas Çertifikatës nga lënda nr.... ZK P.

II. DETYROHET, i padituri që pasurinë kontestuese t ia njohin, të durojnë dhe paditësi të regjistrohet si pronarë, në DGJKP të Gjilanit, këtë në afat prej 15 ditësh, pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me vëretje të përmbarimit të detyruar.

III. Në bazë të nenit 450 të LPK-ës, gjykata vendosi, sejcila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi, A. M. , me padi-kërkespacinë të ushtruar më dt...., kishte konfirmuar se në vitin 1989, sipas kontratës verbale e kishte bler pasurinë kontestuese prej të paditurit Kujtim Shemsiu, nga f. P, për çmimin kontraktues në lartësi prej 9.000,00 DM dhe pas përmbushjes të detyrimeve kontraktuese, paditësi është futur në posedim dhe shfrytëzim të pasurisë kontestuese i pa penguar nga të paditurit dhe personat e tretë.

I paditurit, Kujtim Shemsiu, nga f. P., me prashtrësën e ushtruar më dt....., me dhënjen e përgjigjes në padi kishte deklaruar se e pranoi dhe e pohoi kërkespacinë e paditësit si të bazuar dhe se është e vërtet se të njejtën pasuri, paditësi e ka blerë dhe e ka në pronësi faktike, gjykatës i ka propozuar që të bie aktgjykim në bazë të pohimit-pranimit.

Gjykata, e ka shqyrtuar përgjigjen në padi, duke e aplikuar parimin e ekonomizimit të procedurë pa u lëshuar në administrimin e provave të bie aktgjykim në bazë të pohimit dhe në tërësi të aprovet kërkespacia si e bazuar.

Nga të cekurat më lart, në bazë nenit 148 par.1, të LPK-ës, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Në bazë të nenit 450 të LPK-ës, sejcila palë i bartë shpenzimet e veta të e procedurës kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Gjyqtari
Halil Zahiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të të njejtit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftuara përmes kësaj Gjykate.

